



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-025

Prishtinë, më 21 mars 2018, në orën 14:25

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 MARS 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi dhe Emma Lomax.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Veprimet që duhet të ndërmerren ndaj deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të cilët në sallën e seancës plenare hodhën gaz lotsjellës dhe e pamundësuan vazhdimin e punimeve të seancës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në vazhdimin e seancës së sotme të jashtëzakonshme të Kuvendit, më 21.03.2018, disa deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dy herë radhazi kanë hedhur gaz lotsjellës në sallën e seancave. Andaj, me veprimet e këtyre deputetëve është pamundësuar zhvillimi i punimeve të seancës, si dhe disa deputetë kanë kërkuar trajtime mjekësore, dy prej tyre janë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore.

Kryetari propozoi që, me qëllim të ruajtjes së sigurisë dhe shëndetit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të cilët kanë hedhur gaz lotsjellës, të largohen nga punimet e sotme të seancës së jashtëzakonshme, si dhe të kontrollohet salla dhe të bëhet kontrollimi fizik i deputetëve të GP të “Vetëvendosjes” para se të hyjnë në sallë. Diskutimi i kryetarit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me këtë çështje.

Lidhur me propozimin e lartshënuar të kryetarit të Kuvendit diskutuan: Kujtim Shala dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit me qëndrim unanimit i mori këto vendime:

I. V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli-Dalipi, Drita Millaku dhe Sali Zyba, për hedhjen e gazit lotsjellës në seancën plenare të mbajtur më 21 mars 2018, ndërsa Liburn Aliu për dëmtimin e pajisjeve të sallës plenare, u shqiptohet masa disiplinore ndalimi i pjesëmarrjes në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 21 mars 2018.

2. Deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, gjatë hyrjes në sallën e seancave plenare t’i nënshtrohen kontrollit nga përgjegjësit e sigurisë në Kuvend - Policia e Kosovës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II. V E N D I M

1. Kërkohej nga Policia e Kosovës që, për shkaqe sigurie dhe krijimit të kushteve për punë normale në seancë plenare, ta kontrollojë sallën e seancave plenare të Kuvendit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryesia vendosi që seanca e jashtëzakonshme t'i vazhdojë punimet në orën 15:15.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale